

L I G J
Nr.8022, datë 2.11.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7677, DATË 9.3.1993 “PËR TATIMIN MBI FITIMIN”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Përfshihen nga tatimi mbi fitimin Ndërmarrja e Transportit Ajror (Albtransporti) dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror (ANTA) për të ardhurat aeroportuale e navigacionale që realizohen në aeroportin e Rinasit deri në shlyerjen e kredisë për rikonstrukcionin e këtij aeroporti dhe efektet financiare fillojnë më 1 janar 1996.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1281, datë 15.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha